



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
AGJENCIA E SHËRBIMEVE  
MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**PA 1 Nr. 08-81**

**28.02.2023**

**Shkup**

Këshilli i Agjencisë i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 2 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup> dhe në lidhje me nenin 76 paragrafi (7) dhe nenin 24 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20 dhe 77/21), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 2, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 dhe nenin 51 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i konsoliduar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe nenit 9 të Rregullores për zonat e transmetimit të shërbimeve programore në televizion dhe radio,ark.nr.01-5778/1 datë 21.11.2014 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr.172/14), në lidhje me Kërkesën e dorëzuar për dhënie të lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv, në nivel rajonal (PA1 nr.08-339 datë 7.11.2022, me plotësime nga data 21.12.2022 dhe datë 25.1.2023), nga ana e personit juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, qarkullim dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup dhe Konkluzionin, ark.nr.02-857/3 datë 27.2.2023, në seancën e 8-të mbajtur më 27.2.2023, miratoi:

**VENDIM**

**për dhënie të lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel rajonal**

1. I NDAHET leje për transmetim televiziv të shërbimit programor kryesisht me format të përgjithshëm argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, në zonën e shpërndarjes D1 Crn Vrv – zonë e nivelit rajonal Shkup (qyteti i Shkupit dhe komunave Çučer Sandevë, Haračinë, Ilinden, Petrovec, Zelenikovë, Studeniçan dhe Sopot), të subjektit juridik Shoqërisë për prodhimtari, turizëm, qarkullim dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, me NVAQ 7523602.

Shërbimi programor televiziv nga paragrafi (1) i kësaj pike do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs (burim) të kufizuar.

2. Leja nga pika 1. i këtij Vendimi, jepet për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare.

3. Pas marrjes së këtij Vendimi për dhënien e lejes, subjekti (personi) juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, qarkullim dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. i këtij Vendimi, duhet të regjistrojë Shoqërinë Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës pra në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV).

4. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, të cilën e themelon personi juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, qarkullim dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. i këtij Vendimi, do të paguajë një tarifë vjetore në llogari të Agjencisë, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të fakturës së lëshuar nga Agjencia.

<sup>1</sup> Paragrafët (8) dhe (9) janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).

5. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, të cilën e themelon personi juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, qarkullim( shitje) dhe shërbime PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilës i është dhënë leja nga pika 1. i këtij Vendimi, obligohet të fillojë kryerjen e veprimtarisë më datë 1.5.2023.

Në rast të mos respektimit të afatit për fillimin e veprimtarisë të përcaktuar në paragrafin (1) të kësaj pike të Vendimit, Agjencia do t'ia marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është dhënë dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

6. Ky Vendim është përfundimtar dhe do të publikohet në uebfaqen e Agjencisë.

### **A r s y e t i m**

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) në pajtim me nenin 76 të Ligjit të Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), jep leje për transmetim në televizion dhe radio përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resur (burim) të kufizuar ose nëpërmjet satelitit, për të cilin nuk shpallet konkurs publik dhe leja jepet me kërkesë të palës së interesuar në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me Ligjin e lartpërmendur.

Personi juridik Shoqëria për prodhimtari, turizëm, tregti dhe shërbime (SHPTTSH) PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup më 7.11.2022. drejtuar Agjencisë ka paraqitur Kërkesë për dhënien e lejes pa shpallje të konkursit publik PA1 nr.08-339, për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal D1 Crn Vrv/Shkup, i cili do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim (resurs) të kufizuar.

Pas pranimin të Kërkesës për dhënien e lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv, PA1 nr.08-339 datë 7.11.2022., Shërbimi profesional i Agjencisë vazhdoi shqyrtimin e së njëjtës, duke konstatuar se kërkesa e paraqitur nuk është plotësuar siç duhet dhe përmban disa mangësi. Për sa më sipër, Agjencia në pajtim me nenin 76 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, më 24.11.2022., me shkresë-Njoftim zyrtar, PA1 nr.08-339 datë 24.11.2022., ka njoftuar aplikuesin e kërkesës – personin juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup dhe e obligon që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimin të Njoftimit, të plotësojë kërkesën në fjalë dhe të menjanon mangësitë e konstatuara. Parashtruesi i kërkesës, në afatin e caktuar nga Agjencia, përkatësisht më 21.12.2022. ka dorëzuar një Përgjigje (PA1 nr.08-339) ndaj Njoftimit të Agjencisë (PA1 nr.08-339 datë 24.11.2022.) me të cilën është plotësuar Kërkesa për dhënie të lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv (PA1 nr.08-339 datë 7.11.2022). Pasi i shqyrtoi plotësimet Shërbimi profesional i Agjencisë ka konstatuar se sërish ka disa mangësi që duhet të menjanohen, në lidhje me të cilat parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Shkresë-Njoftim zyrtar PA1 nr.08-339 datë 10.1.2023., për të menjanuar mangësitë dhe përsëri e obligon në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimin të Njoftimit, të plotësojë Kërkesën për dhënie të lejes pa shpallje të konkursit publik (PA1 nr.08-339 datë 7.11.2022 me plotësim nga 21.12.2022). Më datë 25.1.2023., parashtruesi i kërkesës, personi juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, sërish në Agjenci ka dotëzuar plotësim të Kërkesës PA1 nr.08-339, për dhënie të lejes pa shpallje të konkursit publik për transmetim televiziv. Pas shqyrtimit të kërkesës, u konstatua se e njëjta është e rregullt dhe e plotë.

Agjencia, me qëllim të vërtetimit të drejtë të fakteve gjatë miratimit të vendimit për dhënie të lejes për transmetim televiziv, gjegjësisht për të përcaktuar se në cilat Shoqëri Tregtare paraqitet si themelues/pronar personi juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, si dhe themelues i këtij personi juridik (i cili në të njëjtën kohë është edhe drejtues), më 6.2.2023 përmes sistemit shpërndarës të Internetit të Regjistrin Qendror të RMV-së ka ofruar „Informacion për subjektet e ndërlidhura (persona të autorizuar, organet e menaxhimit, pronarë në subjekte të tjera) – gjendja vijuese“ për SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup dhe për personin fizik Petar Karevski, dhe nga Regjistri i pronarëve përfitues ka ofruar dhe gjendjen vijuese për personin fizik – pronar i vërtetë“ (i yni Pa1 nr.08-339 datë 7.2.2023), nga ku mund të shihet se në cilat subjekte ky person paraqitet si pronar i vërtetë, nga ku u konstatua se nuk janë shkelur dispozitat nga Kreu IV i LSHMAAV.

Pas shqyrtimit të Kërkesës së paraqitur për dhënie të lejes pa shpallur konkurs publik për transmetim televiziv, në nivel rajonal (Pa1 nr.08-339 datë 7.11.2022, me plotësim nga data 21.12.2022 dhe nga 25.1.2023), dhe në përputhje me nenin 76 paragrafi (7) të LSHMAAV, është përcaktuar se aplikanti në fjalë i përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në

LSHMAAV dhe rregulloret e miratuara në bazë të këtij Ligji, si dhe se aplikanti personi juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, nuk i është marrë leja për transmetim televiziv dhe radio në 5 (pesë) vitet e fundit.

Në pajtim me nenin 76 paragrafi (7) të LSHMAAV, Agjencia do të marrë vendim për dhënie të lejes në afat prej tre muajsh nga dita e pranimit të kërkesës së rregulluar (kompletur), nëse konstaton se aplikuesi i përmbush kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregulloret e miratuara në bazë të tij dhe nëse kërkesit nuk i është marrë leja për transmetim në televizion dhe radio.

Rrjedhimisht nga sa më lartë, Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, drejtuar Këshillit të Agjencisë dorëzoi Propozimin PA1 nr.08-81 datë 24.2.2023. për marrje të Vendimit për dhënie të lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar, në nivel rajonal.

Pas marrjes së këtij Vendimi për dhënie të lejes, personi juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. i këtij Vendimi, duhet të regjistrojë Shoqëri Tregtare Radiodifuzive në regjistrin përkatës në Regjistrin Qendror të RMV-së. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilit i është dhënë leja nga pika 1. i këtij Vendimi, do të paguajë tarifë vjetore në llogarinë e Agjencisë, për çdo vit aktual duke filluar nga data e dhënies së lejes në afat (brenda) 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia. Mënyra e llogaritjes, faturimit dhe pagesës së kompensimit për lejen e transmetimit televiziv sipas kërkesës përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar, përcaktohet nga Agjencia në përputhje me nenin 80 të Ligjit të lartpërmendur dhe në përputhje me Rregulloren për procedurat e punës financiare dhe kontabël të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014. Shoqëria tregtare Radiodifuzive, e cila do të themelohet nga personi juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup, të cilës i është dhënë leja nga pika 1. E këtij Vendimi, obligohet të fillojë kryerjen e veprimtarisë më datë 1.5.2023., dhe nëse bartësi i lejes nuk fillon me kryerjen e veprimtarisë në afatin e përcaktuar në leje, Agjencia në pajtim me nenin 82 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, do ta marrë lejen e dhënë para skadimit të afatit për të cilën është lëshuar dhe do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, Këshilli i Agjencisë në seancën e 8-të, mbajtur më 27.02.2023., dhe në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-857/3 datë 27.2.2023., miratoi Vendim si në dispozitiv, i cili është përfundimtar dhe pas miratimit të tij të botohet në uebfaqen e Agjencisë.

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale,  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi Aplikanti për dhënie të lejes për transmetim televiziv përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik, nëse nuk pajtohet me vendimin, ka të drejtë padie para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga pranimi i tij.

**Kopje e Vendimit t'i dorëzohet:**

- personit juridik të SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup;
- drejtuesit të personit juridik SHPTTSH PREOBRAZBA SHPKNJP Shkup;
- Drejtorit të Agjencisë,
- Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të Agjencisë;
- Sektorit për çështje juridike dhe furnizime publike, dhe
- Personat e emëruar për udhëheqjen e Regjistrin (PA1).